



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSISË

Tiranë, më 16. 7. 2019

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

MBI

PROJEKTLIGJIN,

**“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9636, DATË 6.11.2006,
“PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT””, TË
NDRYSHUAR**

I. Hyrje

Projektligji, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit””, të ndryshuar, është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Projektligji është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, e shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator znj. Edlira Bode.

Në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar, mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm Znj. Ogerta Manastirliu, Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1, të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi, objektivat, efektet e synuar të propozimit dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit:

Ky projektakt ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit dhe rritjen e monitorimit të duhanpirjes në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu të sigurojë mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga produktet e duhanit. Të forcojë rolin monitorues të Inspektoratit përgjegjës për shëndetësinë, në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e shëndetit nga duhani.

Objektivat dhe efektet e synuara të propozimit:

Ligji nr.9636 i datës 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” përbën kuadrin ligjor për mbrojtja e shëndetit publik nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të tyre.

Ky ligj është ndryshuar me ligjin nr. 49/ 2013 dhe ligjin nr. 76/2014 ky i fundit ndër të tjera parashikoi:

- transmetimin çdo muaj të programe edukative për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit;
- krijimin e hapësirave pa duhan duke ndaluar kështu duhanin në disa mjedise si; punë, institucionet shëndetësore, institucionet arsimore, përfshirë dhe çerdhet; mjetet e transportit publik, përfshirë taksitë; mjediset e mbyllura tregtare, bare, restorante, diskoteka dhe klubet e natës; mjediset e mbyllura kulturore e sportive; mjediset e përbashkëta, në banesat me bashkëpronësi të detyrueshme; mjediset e tjera publike të mbyllura.

Duket se këto ndryshime ligjore mund të kenë patur një impakt pozitiv në uljen e prevalencës së konsumit të duhanit, përderisa statistikatat e reflektojnë një reduktim të numrit të konsumatorëve meshkuj.

Gjithashtu Shqipëria ka ratifikuar Konventën Kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetësisë Me ligjin 9474, datë 09.02.2006 “Për kontrollin e duhanit”, e cila riafirmon të drejtën e për një shëndet të standardeve më të larta dhe ka si objektiv afatgjatë ka uljen e shkallës së konsumit të duhanit dhe për rrjedhojë edhe te efekteve negative në shëndet që lidhen me të. Ratifikimi i kësaj konvente e detyron Shqipërinë si shtet palë të arrijë objektivat dhe detyrimet e vendosura prej saj.

Megjithatë pavarësisht nga masat ligjore, shkalla e pirjes së duhanit është ende e lartë në Shqipëri.. Me synimin e uljes së konsumit të duhanit dhe produkteve të tij projektligji i ri që amendon ligjin aktual, synon vendosjen e masave të tjera të kontrollit të duhanit, si: ndalimi i reklamimit indirekt të produkteve të duhanit, ndalimi i shitjes së paketave me 10 cigare ose më pak, duhanit dhe produkteve të tij me shije të ndryshme nga duhani tradicional, ndalimi i cigareve elektronike në hapësira publike

IV. Efekti Financiar

Projektligji nuk parashikon efekte financiare në buxhetin e shtetit, pasi zbatimi i tij do të sigurohet nga strukturat aktuale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet në varësi të saj.

V. Konsultimi Publik

Projektligji është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Gjatë hartimit të projektligjit janë zhvilluar konsultime të hapura në mjedisiet e MSHMS

VI. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij bëri një pasqyrim dhe analizë të detajuar të projektligjit. Ai u shpreh se duhanpirja është një nga faktorët kryesorë të riskut për sëmundjet kronike të cilat janë shkaku kryesor i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në vend. Prevalenca e duhanpirjes ngelet ende e lartë në vendin tonë dhe është e rëndësishme të reduktohet në mënyrë që të reduktohen edhe sëmundjet kronike. Ligji për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit ka shërbyer si instrument kyç për kontrollin dhe rregullimin e produkteve të duhanit në vitet e fundit, duke dhënë rezultate pozitive. Këto rezultate konkretizohen në trendin në rënie të prevalencës së duhanpirjes të meshkujt.

Pavarësisht kësaj, shumë aspekte të duhanpirjes dhe risqeve të lidhura me këtë fenomen ngelen të pa mbuluara nga ligji aktual. Këto aspekte përfshijnë mungesën e kuadrit rregullator për produktet e reja të duhanit që kanë hyrë në treg vitet e fundit, persistimin e promovimit indirekt të produkteve të duhanit pavarësisht se ligji nuk e lejon asnjë formë të promovimit të tyre dhe moszbatimin korrekt të masave ndëshkuese në rast shkelje administrative që lidhet me produktet e duhanit.

Projektligji i paraqitur vjen edhe në zbatim të politikave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit.

Anëtarët e tjerë të komisionit, theksuan rëndësinë e këtij projektligji në kuadër të përmirësimit të skemës së asistencës sociale.

Në përfundim Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, duke ritheksuar dhe vlerësuar se miratimi i këtij projektligji është i nevojshëm dhe sjell elementë të shumtë të shtuar, në kuadër të mbrojtjes së individëve jo duhanpirës.

VII. Përfundime dhe ndryshimet e projekt aktit (nen për nen)

Në përfundim të shqyrtimit të projektligjit, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, duke vlerësuar si tejet pozitive ndryshimet që vijnë përmes këtij projektligji, me votat pro të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim nen për nen dhe në tërësi me ndryshimet e mëposhtme:

- Në nenin 1 të projektligjit shtohet një pikë 2 me këtë përmbajtje:

“2. Në pikën 18 pas fjalëve “plotësisht me mure” shtohen fjalët“ dhe çdo lloj materiali tjetër”.

- Neni 3 riformulohet me këtë përmbajtje”

“Neni 3

Neni 8 ndryshon si më poshtë vijon:

1. Prodhuesit dhe/ose importuesit e produkteve të reja të duhanit, përfshirë cigaret elektronike dhe duhanin me ngrohje, janë të detyruar të njoftojnë Ministrinë përgjegjëse për Shëndetësinë, për produktet e duhanit që qarkullojnë në tregun vendas, si dhe për çdo rast kur prej tyre hidhet në treg një produkt i ri i duhanit. Ky lajmërim duhet dorëzuar në formë elektronike, jo më vonë se 30 ditë para hedhjes në treg të produktit. Njoftimi duhet të përmbajë:

- a. Informacion kontakti të prodhuesit ose importuesit në Shqipëri;
- b. Një përshkrim i detajuar i produktit,
- c. Instruksionet e lidhura me përdorimin e tij,
- d. Një listë të të gjithë përbërësve të përdorur në fabrikimin e produktit të duhanit dhe sasitë e tyre, arsyen apo qëllimin e përdorimit të këtyre përbërësve, si dhe të përcaktojnë funksionimin dhe kategorinë e përbërësve. Kjo listë duhet të shoqërohet me të dhëna toksikologjike, të disponueshme prej fabrikuesit apo importuesit, në lidhje me këta përbërës, në formë të djegur apo të padjegur, duke u shprehur në mënyrë të veçantë për efektet e tyre mbi shëndetin dhe duke vlerësuar çdo efekt që shkakton ose mendohet se mund të shkaktojë varësi të përdoruesit ndaj produktit të duhanit.
- e. Materialet e disponueshme të kërkimeve shkencore, rrezikun e varësisë dhe tërheqjen e produktit.”

- Pas nenit 7 të projektligjit shtohet neni 8 me këtë përmbajtje:

“Neni 8

Në nenin 19 dhe në gjithë përmbajtjen e tekstit të projektligjit fjalët “inspektorati që mbulon fushën e shëndetit” zëvendësohet me fjalët “struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit”.

- Neni 8 që tashmë bëhet neni 9 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 9

Në nenin 20 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas gërmës a të pikës 1 shtohet gërma a/a me këtë përmbajtje:

“a/a. Shkelja e nenit 8 dënohet me gjobë 500 000 lekë gjobë për prodhuesit dhe/ose importuesit e produkteve të reja të duhanit.”

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Për shkelje të nenit 15 dy herë brenda një periudhë 3-mujore, subjekti i tatueshëm dënohet me gjobë sa dyfishi i gjobës së vendosur në nënndarjen “i”, të shkronjës “ë”, të këtij neni.

Nëse subjekti i tatueshëm i penalizuar për herë të dytë gjendet përsëri në shkelje nenit 15 brenda një afati kohor 1 vjeçar atëherë ndaj tij vendoset gjobë në vlerën gjashtëfishi i gjobës së vendosur në nënndarjen “ii”, të shkronjës “ë”, të këtij neni, dhe pezullim të aktivitetit deri në shlyerjen e masave të gjobës.”

- Pas nenit 9 shtohet neni 10 me këtë përmbajtje:

“Neni 10

Ngarkohet Këshilli i Ministrave brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të paragrafit të dytë të nenit 6 të këtij ligji”

- Neni 9 që tashmë është neni 11 i këtij projektligji riformulohet me këtë përmbajtje :

“Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të paragrafit 1, 3 dhe 4 të nenit 6 të këtij ligji që hyn në fuqi 24 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYETAR

RELATOR

Enver ROSHI

Edlira Bode